REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 25/17
Datë/Datum. 06.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova –Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

## AKT PËRCJELLËS

| | |
|---|---|
| REFERENCË: | 25/17 |
| PËR: | - Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)<br>- Parashtruesit të ankesës **"HIB PETROL" sh.p.k.** me seli në Prishtinë |
| CC: | - Panelit Shqyrtues në OSHP,<br>- Arkivës në OSHP |
| NGA: | Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci |
| TEMA: | Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"HIB PETROL" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 25/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Lokacioni: | Prishtinë | Data: | 06.02.2017 |
| PËR AKTIVITET | | | X |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR | | | X |
| PËR KOMENTE | | | X |
| PËR INFORMIMIN TUAJ | | | X |

*Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit* **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"HIB PETROL" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 25/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

*AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së*

*Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.*

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bullabani | | 30.01.2017 | | 31.01.2017 | | 06.02.2017 |
| *Nënshkrimi i ekspertit* | | *data e autorizimit të eksp.* | | *data e fillimit të ekspertizës* | | *data e dorëzimit të raportit* |

**N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-**

Me datë 25 janar 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"HIB PETROL" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me karburante",** me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

**N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "HIB PETROL" sh.p.k.** me seli në Prishtinë

*Pikat e Ankesës:*

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelej e nenit 28 të LPP-së, Specifikimet teknike;
- Shkelje e nenit 30 të LPP-së, Nën-kontraktimi;
- Shkelje e nenit 71 të LPP-së, Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorëve e Huaj Ekonomik.

*Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:*

Duke u mbështetur ne kërkesat e FDT-së, neni 6.4 Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, njëherit neni 12.1 Nen kontraktimet dhe gjithashtu te kërkuara ne Aneksin 9 - Lokacioni i pikave te karburantit, ju informojmë se duke u mbështetur ne kërkesat tona për marrjen e deklaratës nen betim te disa pikave ku ka qene e obliguar marrja e nen kontraktimeve dhe si e tille ka qene kriter për përshtatshmërinë e Operatoreve Ekonomik kemi hasur ne refuzim për shkak te monopolit te krijuar nga një ose me shume operator ekonomik për bllokimin e dhënies te dokumenteve te cilat janë obligative për dorëzim. Pas shume negociatave kemi zhbllokuar dhënien e këtyre deklaratave mirëpo ne Mamushe ka qene e pamundur për shkak te dhënies se një Operatori tjetër i cili ne një forme ose tjetër ka krijuar monopol për atë zone. Pika te tjera ne Mamushe janë jashtë parametrave te kërkuara ne FDT. Duke u mbështetur ne nenin 28 dhe nenin 7 pika 4 te LPP mendojmë se rezulton ne diskriminim territorial. Kriteret e tilla dhe qasja e OE ne transparence dhe ne mos krijimin e monopolit ka dështuar dhe presim nga AK qe monopoli te mos lejohet dhe te korrigjohet distanca deri ne 20 km për zonën e caktuar. Duke u bazuar ne shpenzimet te cilat i ka ajo zone rezulton ne një vlere minimale ne krahasim me furnizimet e autoriteteve tjera ne Lotin e caktuar.

MONOPOLI i jashtëm i krijuar si pasoje e kërkesave jo te qëllimta nga AK-ja por te thjeshta për pjesëmarrje ne aktivitetit e prokurimit te përmasave te tilla ka krijuar një precedent tjetër ku sipas burimeve tona ne teren (mbështetur ne deklarimet e nen kontraktoreve te shumte me te cilët kemi bashkëpunim te gjate dhe te suksesshëm), një kompani e vetme ka krijuar rrjetën e dy konzorciumeve për pjesëmarrje ne ketë aktivitet edhe ne Lotet tjera, edhe pse sipas AK dhe planifikimeve është dashur qe një kompani te konkurrojë vetëm ne 2 Lote. Kjo është bere për mos krijimin e Monopolit mirëpo Monopoli veçse është bere dhe është dorëzuar ne zyrat e AQP-se. Deklaratat tona bazohen ne marrjen e deklaratave nen betim dhe krijimit te grupeve nga i njëjti person (kompani) qe qëndron mbrapa këtyre furnizimeve. Monopoli është i dënuar me ligj, si direkt ashtu edhe indirekt. Kriteret e dobëta dhe te thjeshta për ketë aktivitet voluminoz kane mundësuar krijimin e këtij monopoli. Kërkesat tona paraprake te prezantuara edhe ne konferencën para kualifikuese edhe ne ankesën e bere ndaj aktivitetit kontraktues për:

1. Autorizim Prodhuesit
2. Referenca dhe kontrata
3. Mjetet transportuese
4. Licenca për deponim kane qene disa nga kriteret qe nuk paraqesin diskriminim sepse neni 71 i LPP, neni 11.1 i FD7, jep mundësinë e krijimit te grupeve dhe konzorciumeve për plotësimin e kritereve dhe shmangien e këtij monopoli.

Mbështetur ne propozimet tona janë edhe dosja e tenderit te AQP-se 2014 dhe AQP-se 2015, ku ka pasur konkurrencë dhe konzorciume. Ne asnjë moment nuk jemi e vetmja kompani qe mund te posedojmë dokumentacione te kërkesave te lartpërmendura dhe ne asnjë mënyrë nuk është kërkesë monopoliste, mirëpo kriteri i tille krijon konkurrimin ne Lotet e propozuara, konkurrence dinjitoze, prezantimin e kompanive te kapaciteteve administrative, teknike dhe profesionale dhe mos dhënien e mundësisë se prezantimit te kompanisë se njëjtë dhe kapaciteteve te saj ne te gjitha lotet si prapavije ose prezantim direkt. Nëse informatat e tona për këtë monopol nuk do te merren seriozisht nga AK edhe pse janë totalisht te argumentuara dorëzimet e dosjeve minimum 20 dite para afatit për dorëzimin e ofertave (gjithnjë bazuar të dhënave të nen kontraktorëve dhe pjesëtarëve të konzorciumit) atëherë do te obligohemi që deklaratat për krijimin e këtij monopoli t'i dorëzojmë ne Krimet Ekonomike dhe institucionet përgjegjëse tjera të Republikës së Kosovës.

Kompania "HIB PETROL" mbështetur ne argumentet e ofruara kërkon nga AK-ja që të:

Anulojë procedurën e këtij aktiviteti;

Analizojë dhe vendos kritere të cilat në asnjë mënyrë nuk do të lejonin krijimin e monopolit direkt apo indirekt në interes të transparencës dhe konkurrencës.

**Procesi i prokurimit**

| | |
|---|---|
| *Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1)* | UA/2016/16/261/111 |
| *Data e njoftimit për kontratë (N. 40)* | 01.12.2016 |
| *Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-* | Procedura e hapur |
| *Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):* | Furnizim /e madhe |
| *Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19):* | 14,650,000.00 € 36muaj |

*Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9):* .....

*Afati kohor për pranimin e projekteve (gjithsejtë ditë):* .....30.12.2016

**Kriteret për vlerësim**

*Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):* .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët.

*Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri* (N.65-69):

- Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat e specifikuara në nenin 65 të LPP-së.

*Dëshmitë dokumentare:*

- Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

- Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit AQP-ja ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohorë për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AQP-së për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe AQP-ja do të vazhdoj me tenderuesin e radhës në rang-listë .

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

- Vërtetim të lëshuar nga gjykata apo autoritet administrative të vendet e themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65 paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1,3.2,3.3,3.4,3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 41, 4.2 dhe 4.4 ( jo më i vjetër se 6 muaj para datës së dorëzimit të tenderit) kërkohet origjinal ose kopje e noterizuar.

- Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së dorëzimit të tenderit- kopja.

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

*Kërkesat përshtatshmërisë profesional* (N. 66):

- Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
- Regjistrimi i TVSH;
- Regjistrimi i Numrit Fiskal
- Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga MTI për import, shitje me shumicë dhe transport të derivateve të karburanteve.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
- Certifikata e TVSH- kopje
- Certifikata e numrit fiskal- kopje
- Licencat për shërbime ne sektorin e karburanteve:
  1. Licenca e importit- Vërtetimi i kopjes i noterizuar nga origjinali;
  2. Licenca për deponim- Vërtetimi i kopjes i noterizuar nga origjinali;
  3. Licenca e shitjes me shumicë- Vërtetimi i kopjes i noterizuar nga origjinali;
  4. Licenca e transportit- Vërtetimi i kopjes i noterizuar nga origjinali;
  5. Licenca e shitjes me pakicë për pikat e karburantit ku operatori ekonomik ofron furnizime me karburante e të cilat i ka në pronësi apo të marruar me qira- Vërtetimi i kopjes i noterizuar nga origjinali;

- Të gjitha licencat e lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet që te kenë afat validitetit.
- Për pikat e karburantit që priten të nënkontraktohen, Licencat e shitjes me pakicë dhe marrëveshja për nën-kontraktim duhet të noterizohet nga operatori ekonomik që supozohet që të shpërblehet me kontratë.
- Dokumentet (Licencat e shitjes më pakicë të pikave te karburanteve të nën-kontraktuara dhe marrëveshjet për nën-kontraktim) duhet të dorëzohen të AK-së-AQP në afat prej 7 ditësh nga kërkesa e AK-së para publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës.
- Dështimi i operatorit ekonomik që është supozuar që të shpërblehet me kontratë të sjell licencat e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nën-kontraktim për pikat e karburanteve të nën kontraktuara, i jep të drejtë AK-së që ofertën ta refuzoj, ta bëjë konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës më operatorin ekonomik që është rendit ne vendin e dytë e kështu me radhë.

*Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ( neni 68 të LPP-së )*

- Operatori ekonomik duhet te ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit ( 2013, 2014 dhe 2015) një xhiro totale në EURO të barabartë ose më shumë se:

Pjesa 1: 9,000,000.00€
Pjesa 2: 3,800,000.00€
Pjesa 3: 2,200,000.00€
Pjesa 4: 1,600,000.00€
Pjesa 5: 1,600,000.00€
Pjesa 6: 2,500,000.00€

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 pjesë (lote),shuma totale e qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat ai konkurron duhet te përmbushet nga OE.
Shembull: nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 9,000,000.00€ dhe për Lot 2 është 3,800,000.00€, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet të përmbushet nga OE është 12,800,000.00€.

- Sigurimi i tenderit:

  Pjesa 1: 180,000.00€
  Pjesa 2: 75,000.00€
  Pjesa 3: 45,000.00€
  Pjesa 4: 30,000.00€
  Pjesa 5: 30,000.00€
  Pjesa 6: 50,000.00€

- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuar ne ATK ( 2013, 2014 dhe 2015).

*Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ( neni 69 të LPP-së )*

- Operatori ekonomik duhet të dorëzoj një listë të pikave të shitjes së karburanteve që planifikon për ti shfrytëzuar për realizimin e kontratës. Vendet e pikave të shitjes të cilat kërkohen janë të specifikuara në Aneksin 9;

- Tenderuesi duhet të dorëzoj Certifikatën e cilësisë së mallrave të ofruara nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të Cilësisë.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Plotësimi i Aneksit 9- te dosjes së tenderit-Lokacionet e pikave të karburantit.

- Certifikata nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të Kualitetit- origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinale.

**Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)**

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

***Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).***

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, furnizim, vlerë e madhe. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

***Sqarimi: Nr. 2***

Operatori ekonomik ankues "HIB PETROL" sh.p.k., me dt. 19 janar 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetit kontraktues- AQP, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, gjatë fazës së tenderimit .

Me dt. 20 janar 2017, autoriteti kontraktues – AQP, merr vendim të refuzoj si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE "HIB PETROL" sh.p.k, dhe të vërtetoj njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111.

***Sqarimi: Nr. 3***

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet autoriteti kontraktues shkelej të nenit 7 dhe 28 të LPP-së respektivisht aty ku thuhet: "*Pas shume negociatave kemi zhbllokuar dhënien e këtyre deklaratave mirëpo ne Mamushe ka qene e pamundur për shkak te dhënies se një Operatori tjetër i cili ne një forme ose tjetër ka krijuar monopol për atë zone. Pika te tjera ne Mamushe janë jashtë parametrave te kërkuara ne FDT. Duke u mbështetur ne nenin 28 dhe nenin 7 pika 4 te LPP mendojmë se rezulton ne diskriminim territorial. Kriteret e tilla dhe qasja e OE ne transparence dhe ne mos krijimin e monopolit ka dështuar dhe presim nga AK qe monopoli te mos lejohet dhe te korrigjohet distanca deri ne 20 km për zonën e caktuar*", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes shkresës elektronike ( emalit ), me dt. 20 janar 2017, ka bërë kërkesë për informim te z. Sherif Sherifi- Drejtor i Departamentit Rregullimit të Tregut Naftës në MTI, ku thuhet: *AQP-ja në përputhje me LPP-në dhe UA-05-2016, është duke zhvilluar procedurën e prokurimit* ***"Furnizim me karburante"****, ku kemi nevojë për informacion se sa është numri i bizneseve (pompa) të cilat ushtrojnë veprimtari në KK Mamushë dhe janë të licencuar nga autoriteti i juaj.*

Po të njëjtën datë z. Sherif Sherifi- Drejtor i Departamentit Rregullimit të Tregut Naftës në MTI, i kthen përgjigje autoritetit kontraktues me te dhëna ku figuron lista me 8 ( tete) operator ekonomik.

Po ashtu, përmes shkresës elektronike ( emalit ), me dt. 20 janar 2017, autoriteti kontraktues ka bërë kërkesë për informim në zyrën e prokurimi ne K. Mamushë, ku thuhet: *AQP-ja në përputhje me LPP-në dhe UA-05-2016, është duke zhvilluar procedurën e prokurimit* ***"Furnizim me karburante"****, ku edhe autoriteti juja është përfshirë në këtë udhëzim dhe dosje tenderit. Largesia maksimale e pikave të karburantit që OE ka në pronësi apo të marruara më qira mund të jetë deri 10km nga ndërtesa e Kuvendit Komunal. Për pikat e karburantit që nënkontraktohen, largësia maksimale mund të jete deri në 0-10km nga ndërtesa e Kuvendit Komunal. Distanca e pikës se karburantit së deklaruar nga OE do të matet nga Ndërtesa e Komunave duke e përdorur faqen e internetit VIAMICHELIN.*
*Ju lutem na informoni sa më shpejt që është e mundur se brenda këtij perimetri të caktuar sa biznese ushtrojnë këtë veprimtari. Nga ndërtesa e KK Mamushë në perimetrin 0-10km se sa biznese posedojnë pompa për derivate.*

Po të njëjtën datë, zyra e prokurimit K. Mamushë i kthen përgjigje autoritetit kontraktues ku thuhet: ne konsultim me inspektoret komunal, u informova se brenda distancës së kërkuar nga objekti i Komunës së Mamushës (0-10km), operojnë rreth 8 ( tetë) operator ekonomik të cilët posedojnë pompa për shitjen e naftës dhe derivateve të saja.

Bazuar në atë që u tha më lartë si dhe duke pasur parasysh faktin se autoritetit kontraktues aktivitetin e prokurimit e ka ndarë në 6 (gjatë) Lote dhe ka specifikuar se tenderuesi mund të paraqesë tender maksimum 2 (dy) pjesë, ekspertja shqyrtues mendon se autoritetit kontraktues ka të ndërmarrë masa të nevojshme për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të operatorëve ekonomik në aktivitetin e prokurimit *"Furnizim me karburante"*.

***Sqarimi: Nr. 4***

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Kriteret e dobëta dhe te thjeshta për ketë aktivitet voluminoz kane mundësuar krijimin e këtij monopoli. Kërkesat tona paraprake te prezantuara edhe ne konferencën para kualifikuese edhe ne ankesën e bere ndaj aktivitetit kontraktues për: 1. Autorizim Prodhuesit; 2. Referenca dhe kontrata; 3. Mjetet transportuese; 4. Licenca për deponim kane qene disa nga kriteret qe nuk paraqesin diskriminim sepse neni 71 i LPP, neni 11.1 i FD7, jep mundësinë e krijimit te grupeve dhe konzorciumeve për plotësimin e kritereve dhe shmangien e këtij monopoli*", ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 66 dhe nenin 69 të LPP-së dhe nenin 26 te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik ( i dt. 01.11.2016), sqaron se është e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit të specifikoj kriteret minimale për kualifikim të operatorëve ekonomik të cilat i konsideron të nevojshme që operatoret ekonomik duhet të posedojnë lidhur me kërkesat mbi Përshtatshmëria Profesionale dhe kërkesat mbi Aftësi teknike apo profesionale.

Lidhur me kërkesat e specifikuar ne dosjen e tenderit për kualifikim të operatorëve ekonomik, edhe Shoqata e ndërmarrjeve që merren me qarkullimin e naftës, derivate të naftës, gazrave dhe lubrifikanteve "SHQNDGL", me dt. 12 dhjetor 2016 , ka bërë kërkesë në AQP, ku ndër të tjera thuhet: *Ankesat e shumta nga bizneset rreth kriterit të licencës për deponim dhe arsyet e dhëna nga bizneset na bind neve se ky kriter duhet të largohet nga kriteret, përderisa MTI ju jep mundësin e importit pa pasur nevojë për deponi, kjo duhet të merret parasysh edhe nga ana e juaj.*

*Që nga fillimi i aplikimit të disa kritereve si p.sh. Licenca e për deponim, Autorizimi i prodhuesit e disa kritere të tjera të panevojshme në shumë tender ju ka pamundësuar konkurrimin kompanive që në të kaluarën kanë bërë furnizim për shumë AK-së, edhe pse kanë përvojën dhe kapacitetet e mjaftueshme për furnizimet me karburante për AK-së në këtë tender edhe pse nuk kanë pasur licencën për deponim.*

| |
|---|
| *Këto kriter kanë minimizuar mundësin e konkurrimit dhe rrjedhimisht kanë krijuar favorizim të 2 apo 3 kompanive, kompani të cilat pas aplikimit të kritereve të cekuar më lartë kanë përfituar thaj se të gjithë tenderët.* |
| |

**Mendimi i Ekspertit Shqyrtues**

| |
|---|
| Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **"Furnizim me karburante"**, me nr. të prokurimit AQP/16/001/111, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për kontratë, të dt. 01 dhjetor 2016. |
| |